

01 Nr. 109/22 Dt. 30.08.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi



Komuna e Suharekës
Opština Suhareka

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUHAREKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NË DORËZIM - PRIMLJENO - RECEIVED			
Nësta org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Braj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	57/00	7

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 13 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe në kërkesën nr. 2720/22 të datës 22.08.2022, kontratën e punës nr. 252/15 të datës 21.10.2015 të parashtruar nga Nora Shantiri-Bytyqi, kërkesën e datës 16.08.2022, kontratën nr. 21/2017 të parashtruar nga Jetesa Bytyqi, pëlqimin me nr. 259/22 të datës 16.08.2022, pëlqimin nr. 267/ 2022 të datës 12.08.2022, lidhin këtë;

MARRËVESHJE TË MIRËKUPTIMIT

E hartuar me datën 26.08.2022 në Komunën e Prizrenit e lidhur në mes palëve si më poshtë;

- z. Shaqir Totaj - Kryetar i Komunës së Prizrenit, përfaqësuar nga njëjën anë dhe
- z. Bali Muharremaj – Kryetar i Komunës së Suharekës, përfaqësuar në anën tjetër,

Neni 1.

Qëllimi i kësaj marrëveshje të mirëkuptim është transferim i përhershëm i mësimdhënësve të cekura në nenin 2, të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit

Neni 2.

Komuna e Prizrenit, përkatësisht Drejtoria e Arsimit ka dhënë pëlqimin nr. 2747/22 të datës 25.08.2022 që mësimdhënësja Nora Shantiri-Bytyqi e sistemuar në vendin e punës mësuese klasore në SHFMU "Lidhja e Prizrenit" në Prizren, të transferohet në SHFMU "Hasan Prishtina" në Semetisht në Komunën e Suharekës, në të njëjtin vend të punës mësuese klasore.

Komuna e Suharekës, përkatësisht drejtoria e SHFMU "Hasan Prishtina" në Semetisht ka dhënë pëlqimin që mësimdhënësja Jetesa Bytyqi e sistemuar në vendin e punës mësuese klasore në këtë shkollë të transferohet në SHFMU "Lidhja e Prizrenit" në Prizren, në të njëjtin vend të punës mësuese klasore.

Neni 3.

Transferimi i mësimdhënësve të cekura më lartë bëhet me pëlqimin paraprak të tyre, duke mos i dëmtuar në profesionalizëm dhe aftësitë e tyre dhe në nivelin e njëjtë të pagës.

Neni 4.

OBLIGOHEN; Drejtoritë e Arsimit dhe Drejtorët e shkollave përkatëse të të dyja Komunave që mësimdhënësve të cekura në nenin 2, të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit të bëjnë rregullimin e kontratave të punës, rregullimin në sistemin e pagave dhe transferimin e dosjeve personale, të gjitha këto obligime t'i ndërmarrin konform ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Kjo marrëveshje nuk do të aplikohet deri sa të bëhet ndryshimi në listën e pagave në Ministrinë e Financave.

Neni 5.


Të gjitha palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje të mirëkuptimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësitë në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent për të vendos do të jetë Gjykata kompetente.

Neni 6.

Kjo marrëveshje është e përpiluar në 4 ekzemplar identik ku nga një e marrin palët, kurse të tjerat mbesin për nevojat e organit kompetent.

Palët në marrëveshje

Kryetari i Komunës


Shaqir Totaj



Kryetari i Komunës


Bali Muharremaj

